



AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ANONIME
"CENO" SH. A.

Sot ne date 19.02.2005 shtetasi shqiptar:

KRENAR CENO, i biri i Osmenit dhe i Fahries, lindur ne Vlore me 02.01.1965 dhe banues ne Vlore ne adresen: lagje "Rilindja", Rruga «P.Bisha», Nr. 23.

ka themeluar shoqerine anonime "**CENO**" SH.A. si me poshte:

NENI 1

Themelohet Shoqeria Anonime pa oferte publike me emrin "**CENO**" sh.a.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne Pus Mezin (Vlorë). Shoqeria mund te krijoje seli dytesore, filiale, agjensi, zyra perfaqsimi ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 3

Shoqeria ke kohezgjatje te veprimtarise te pakufizuar.

NENI 4

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj vijuesin:

- *Tregtimin me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, materialeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike, elektroshtepiake, pjeseve te kembimit te automjeteve, pajisjeve te zyrave; import – eksporti i tyre;*
- *tregtimi i gazit dhe karburanteve, dhe gjithë nenproduktet e tyre;*



- *aktivitet ne fushen e transportit, per vehte dhe per llogari te treteve; transporte nationale dhe internacionale; transport mallrash dhe pasagjeresh;*
- *hapja e bar-restoranteve, picerive, aktivitet ne fushen e hotelerise;*
- *shoqeria do te kryeje cdo operacion tregtar apo financiar qe lidhet drejt perdrejt apo terthorazi me objektin e saj kryesor perfshire blerjen e shoqerive me objekt te njejte apo te ngjashem; te krijojte ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, mund te japi dorzani, hipoteka dhe lloje te tjera garancish.*

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne masen 2.000.000 (dy milione) leke dhe i ndare ne 2.000 (dymije) aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili qe eshte teresisht kapital financiar i depozituar prej aksionerit te vetem.:

NENI 6

Nenshkruesi deklaron qe menyra e percaktimit te fitimit si dividend, rregullat per thirrjen dhe perberjen e asamblese se aksionereve, te organeve drejtuese, kontrollues, administrues dhe perfaqses te shoqerise, kompetencat dhe detyrat e ketyre organeve, rregullat e zgjedhjes apo emerimit te tyre , rregullat per shkrirjen e shoqerise si dhe te tjera qe kane te bejne me rregullimin e aktivitetit te shoqerise jane te perfshira ne Statutin bashkangjitur.

NENI 7

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.
Ushtrimi i pare do te mbyllet ne 31 dhjetor 2004.

NENI 8

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane:

1. *Rajmonda CENO e bija e Aqifit dhe e Jazes, lindur ne Vlore me 20.01.1968 dhe banuese ne Vlore ne adresen lagjja "Rilindja », rruga « P.Bisha », Nr. 23*



2. *Nurie ADEMI*

i biri i Aqifit dhe i Jazes lindur ne Vlore me 11.05.1965 dhe po aty banuese ne lagje "Isa Buletini »

3. *ARTAN QULLI*

i biri i Çerçizit dhe e Vangjelos, lindur ne Vlore me 18.06.1963 dhe banues ne Tirane

Keshilli Mbikqyres emeroi si Drejtor te Pergjithshem zotin **KRENAR CENO**, duke e autorizuar Drejtori I Pergjithshem te terheqe kapitalin e depozituar per themelimin e shoqerise pas regjistrimit te saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates Tirane.
Duke iu referuar statutit te shoqerise zonja **Rajmonda CENO** u zgjodh ne detyren e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres.

NENI 9

Ekspert kontabel I shoqerise do te jete z. **Namik VEIPI**

NENI 10

Veprimtaria e shoqerise "**CENO**" Sh.A. do te kryhet ne perputhje me normat e legjislacionit dhqiptar dhe per cdo mosmarreveshje eventuale Gjykate kopetente eshte ajo e rrethit Vlore

NENI 11

Kontrata u hartua ne GJASHTE kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi u lexua nga aksioneret u nenshkrua pa asnje verejtje ne prezence te **Noteres JETMIRA VERAJ**.

ORTAKU THEMELUES

Krenar Ceno

Vlore, me nentembedhjete shkurt dymije e pese

[Signature]



S T A T U T I

I SHOQERISE ANONIME

“CENO” SH. A.

Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare” dhe ligjit Nr. 8080 date 01.03.1996 “Per letrat me vlere” shtetasi shqiptar:

KRENAR CENO, i biri i Osmenit dhe i Fahries, lindur ne Vlore me 02.01.1965 dhe banues ne Vlore ne adresen: lagje “Rilindja”, Rruga “P.Bisha”, Nr. 23.

ka themeluar Shoqerine Anonime pa oferte publike te emertuar “**CENO**” Sh. A. e cila do te funksionoje sipas percaktimeve te ketij statuti me permbajtjen e meposhtme: te legjislacionit shqiptar:

KAPITULLI I^e
DISPOZITA TE PERGJITSHME

EMERTIMI- SELIA- KAPITALI THEMELTAR- KOHEZGJATJA

NENI 1

Shoqeria “**CENO**” SH.A. eshte shoqeri anonime pa oferte publike e cila fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 2

Emertimi i shoqerise do te jete “**CENO**” SH.A.

Selia e saj do te jete ne Pus Mezin (Vlore).

Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Zakonshme.

Shoqeria mund te krijojte sipas nevojave te saj dege, filiale dhe perfaqsi ne qytete te tjera te republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 3

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj vijuesin:

- *Tregtimin me shumice dhe pakice te artikuljeve te ndryshem industriale dhe ushqimore, materialeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike, elektroshtepiake, pjeseve te kembimit te automjeteve, pajisjeve te zyrave; import – eksporti i tyre;*
- *tregtimi i gazit dhe karburanteve, dhe gjithë nenproduktet e tyre;*
- *aktivitet ne fushen e transportit, per vehte dhe per llogari te trete ve; transporte nacionale dhe internacionale; transport mallrash dhe pasagjeresh;*
- *hapja e bar-restoranteve, picerive, aktivitet ne fushen e hotelerise;*
- *Shoqeria do te kryeje cdo operacion tregtar apo financiar qe lidhet drejt perdrejt apo terthorazi me objektin e saj kryesor perfshire blerjen e shoqerive me objekt te njejte apo te ngjashem; te krijoje ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, mudn te japi dorzani, hipoteka dhe lloje te tjera garancish.*

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne masen 2.000.000 (dy milione) leke dhe i ndare ne 2.000 (dymije) aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili qe eshte teresisht kapital financiar i nenshkuar prej aksionerit themelues:

NENI 5

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj pa afat te kufizuar.

KAPITULLI II^{te}

DREJTIMI I SHOQERISE DREJTORI- KESHILLI MBIKQYRES

NENI 6

Drejtoria e shoqerise, ne kuptimin e ligjit "Per shoqerite tregtare", perbehet nga Drejtori.

Drejtori eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirefunksionimin e shoqerise, administrimin e pasurise dhe interesave te saj. Ai aplikon metodat dhe menytrat qe i gjykon me te mira, me te pershtatshme dhe me





efektive, per te realizuar objektivat e percaktuara nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja.

Drejtori ka kopetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise dhe kufizohet vetem ne ato kopetenca brenda objktit te veprimtarise se saj. Drejtori zgjidhet me votat oro te te pakten 2/3 te anetareve te Keshillit Mbikqyres per 4 vjet me te drejte rizgjedhje.

Drejtori i pare emerohet z.KRENAR CENO

Drejtori shkarkohet para afatit me votata e te pakten 2/3 te anetareve te Keshillit Mbikqyres. Kjo mund te ndodhe per paaftesi te theksuar profesionale, shendetsore ose perfaje te renda ne drejtimin e shoqerise.

Menyra dhe masa e shperblimit te Drejtorit caktohen nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e zgjedhjes se tij. Te gjitha vendimet e Drejtorit protokollohen dhe ruhen ne arkiv. Drejtori perdor vulen e shoqerise.

NENI 7

Drejtori ka keto kopetenca:

- *Propozon vendime per Keshillin Mbikqyres*
- *Emeron dhe shkarkon zevendOSMENDhe keshilltaret e tij dhe drejtoret e departamenteve, kryetaret e degeve, drejtoret e filialeve dhe shefat e sektoreve si dhe percakton kategorite e pageve te tyre dhe ndryshimet e mundshme kur e sheh te arsyeshme. Kjo kopetence ne raste te vecanta mund te shtrihet edhe per punonjes te tjere te cfaredoshem te shoqerise.*
- *Miraton sasine dhe kualifikimin e nevojshem te personelit te punesuar ne shoqeri.*
- *Perfaqson shoqerine ne mrrredhenie me te tretet.*
- *Miraton dhe nenshkruan kontrate, marrveshje, memorandume, protokolle dhe dokumentate tjere ne emer te shoqerise.*
- *Miraton prokurimet deri ne 20.000 (njetetemije)\$\$. Per prokurimet mbi kete shifer nevojitet edhe miratimi i Keshillit Mbikqyres.*
- *Ka te drejte te delegoje pjese te kopetencave te tij.*
- *Miraton rregulloren e brendshme*
- *Miraton kontraten tip te punes.*
- *Merr vendime per fushtat e marketingut dhe tarifate ose promocionet te tjera gjate tyre.*
- *Merr vendimme per sponsorizimet te ndryshme me qellime marketingu.*
- *Merr vendime per marredhenie financiare brenda shoqerise dhe me te tretet perfshire edhe Bankat.*
- *Merr vendime per hapjen ose mbylljen, tipin, gjendjen, llojin e monedhes etj, te llogarive bankare brenda ose jashte Shqiperise.*



- *Autorizon shperblime te veçanta dhe honorare per punonjes te veçanta te shoqerise ose persona te tjere jashte saj.*
- *Autorizon krijimin, madhesine, llojin dhe perdoriminn e rezervave te shoqerise.*
- *Mban nje llogari bankare te veçante e cila nuk eshte subjket i kontrollit te brendshem te shoqerise dhe per te cilen jep llogari vetem perpara Kryetarit te Keshillit Mbikqyres.*

NENI 8

Keshilli Mbikqyres emerohet nga Asamblea e zakonshme e aksionereve çdo tre vjet. Ai perbehet nga 3(tre) anetare.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te riemerueshem. Ata mund te revokohen nga Asamblea e Zakonshme vetem per shkaqe te perligjura. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres eshte e vlefshem n.q.s. marrin pjese te tre anetaret. Keshilli Mbikqyres mer vendime me shumice votash. Votat e anetareve kane peshe te barabarte. Vota e Kryetarit eshte vendimtare ne rast te votimit te barabarte.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres te pare jane:

- ◆ *Rajmonda CENO,*
- ◆ *Nurie ADEMI*
- ◆ *Artan QULLI*

Kryetar I Keshillit Mbikqyres eshte zj. Rajmonda CENO

Keshilli Mbikqyres mblidhet dhe vendos me propozim me shkrim te Kryetarit te tij ose te Drejtorit.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk duhet te bejne pjese new Keshilla te tjere Mbikqyres ose new organe te tjera drejtuese te shoqerive te tjera anonime qe kane lidhej me kete shoqeri dhe qe zhvillojne veprimtarine e tyre new territorin e Republikes se Shqiperise.

Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak te vdekjes, shkarkimit ose doreheqjes, zevendesimi I tyre behet jo me vone se 3 muaj. Anetari I Keshillit Mbikqyres new zevendesim te nje anetari tjeter perfundon mandatin e paraardhesit . Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres verbalizohen dhe ruhen.

NENI 9

Keshilli Mbikqyres ka keto kepetenca:

- *Zgjedh Drejtorin*
- *Shkarkon Drejtorin me votat e te pakten 2/3 te anetareve.*
- *Miratton transferimin e aksioneve.*



- *Pergatit bilancin vjetor dhe ja paraqet per miratim Asamblese se Zakonshme.*
- *Miraton strategjine e zhvillimit dhe projektet e reja strategjike.*
- *Miraton investimet mbi 20.000 \$.*
- *Miraton marrjen e huave afatmesme dhe afatgjata, dhenien e derezanive ose garancive te jera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarine e zakonshme te shoqerise.*
- *Miraton strukturen e shoqerise, strukturen dhe masen e pagave.*
- *Kontrollon investimet mbi 20.000 \$ ose ekuivalente.*
- *Miraton strukturen e tarifave baze te sherbimit.*
- *Ushtron kontroll mbi Drejtorine per administrimin e mire te shoqerise. Ka te drejte ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij.*
- *Kerkon raport me shkrim nga Drejtoria per çdo tre muaj dhe raportin vjetor brenda tre mujorit te pare te vitit pasardhes.*
- *Jep paraprakisht pelqimin per marreveshjet qe mund te beje shoqeria me nje pjestar te Drejtorise apo Keshillit Drejtues apo kur keta te fundit kane lidhje pronesia me nje subjekt tjetër qe ben marreveshje me shoqerine. Ne kete rast anetari i Keshillit Mbikqyres nuk mer pjese ne votim , gjithashtu ai eshte i detyruar te njoftoje Keshillit Mbikqyres per cdo marreveshje qe ka lidhje me te ne format e mesiperme.*
- *Keshilli Mbikqyres mund te caktoj shperblime te Jashtezakonshme per sherbime apo detyra qe u ngarkohen anetareve te tij.*
- *Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk kanwe te drejte te kontraktone ne çfaredo forme per te marre hau nga shoqerias, te japin nepermjet saj paradhenie apo garanci per detyrime per te tretet.*

KAPITULLI III^{te}

ASAMBLEA E AKSIONEREVE

NENI 10

Mbledhja e Asamblese se aksionereve thirret nga Keshilli Mbikqyres ose nga Drejtori. Gjithashtu ajo mund te thirret nga aksioneret qe zoterojne te pakten 1/10 e aksioneve, nga eksperti kontabel i autorizuar, ne mungese te te pareve, nga likuidatori kur shoqeria eshte ne likujdim ose nga mandatembahtesi i caktuar nga Gjykata.

Njoftimi per mbledhjen e asamblese behet me leter rekomande ne andrese te cdo aksioneri ecila duhet te mbrije te apkten 15 dite para dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, datendhe vendin e



mbledhjes, gjithashtu jo më pak se 15 dite perpara vihen ne dispozicion te aksionereve keto dokumenta:

- teksti i projekt rezolutave te paraqitura
- pasqyre e e permbledhese e gjendjes se shoqerise gjate vitit financiar te kaluar si dhe nje pasqyre permbledhese e rezultateve te pese diteve te fundit.
- raportin e eksperteve kontabel te autorizuar
- emri,mbiemri, te dhenat biografike dhe c.v. kur ka emerime ne rendin e dites.

Mbledhjet e asamblese qe thirren ne menyre te parregullt mund te aullohen perjashto rastin kur te gjithe aksioneret jane prezent.

Votat e aksionereve kane peshe propocionale me kuoten e aksioneve qe ata zoterojne. Cdo aksion jep te drejten e nje vote. Cdo aksioner muind te perfaqsohet new asamble nepermjet nje aksioneri tjeter ose nepermjet nje perfaqsuiesi duke qene keta te autorizuar me procure noteriale.

NENI 11

Asambleja e Zakonshme

Asambleja e zakonshme mer vendime te vlefshme new mbledhjen e pare, vetem n.q.s. aksioneret ose te perfaqsuar zoterojne te pakten 1/3 e aksioneve. Ne rast se kjo mbledhje nuk reqalizohet ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi. Asambleja e zakonshme mer vendime me shumicen e votave qe zoteronjne aksioneret e pranishem ose te perfaqsuar. Mbledhjet e Asamblese se Zakonshme behen te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Mbledhjet e zakonshme mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur aksioneret fizikisht new nje sale. Asambleja e zakonshme mer cdo vendim perjashtuar ato qe jane new kopetence te Asamblese se jashtzakonshme.

Asambleja e zakonshme ka keto kopetence:

- *emeron keshillin Mbykqyres*
- *percakton shperblimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres*
- *miraton politiken e pergjithshme te zhvillimit te shoqerise*
- *miraton pjesmarrjen new shoqeri te tjera*
- *miraton ekspertet kontabel*
- *degjon dhe miraton raportin vjetor te Drejtorit se bashku me llogarite dhe raportin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe mer vendimet per te gjithe ceshtjet financiare te vitit te kaluar*
- *miraton marreveshjet qe behen midis shoqerise dhe nje anetari te drejtorise apo te Keshillit Mbykqyres si dhe te shoqerise me*



subjekte te tjera qe kane lidhje pronesia me personat e sipermendur.

NENI 12

Asambleja e Jashtzakonshme

Asambleja e Jqashtzakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem n.q.s. aksioneret e pranishem zoterojne ne mbledhjen e apre te pakten 2/3 e aksioneve dhe ne te dyten $\frac{1}{2}$ e aksioneve. Ne mungese te setij qourumi mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevonshme, jome te larget se dy muaj, nga data e thirrjes se pare. Ajo mer vendime me nje shumice votash prej $\frac{3}{4}$ qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqsuar. Mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen.

Mbledhja e jashtezakonshme ka keto kopetenca:

- *te ndryshoje statutin e shoqerise*
- *te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te raportit te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres dhe te procedurave te percaktuara ne ligj*
- *te heq te drejten e perparesise se nenshkrimet n.q.s. e sheh te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit*
- *te vendose shkrijen e shoqerise sipas kushteve dhe procedurave te percaktuara ne ligj*
- *te ndryshoje kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorit te pergjithshem.*

KAPITULLI IV^{rt}

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR- TRANSFERIMI I AKSIONEVE

NENI 13

Zmadhimi I kapitalit


Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.

Kjo rritje behet vetem me pelqimin unanim te aksionereve, me perjashtim te Krenar kur kjo realizohet me perfshirjen e rezervave te fitimeve apo primeve te emetimit.

NENI 14

Asambleja e jashtezakonshme eshte i vetmi organ kompetent per te

Vendosur mbi zmadhimin e kapitalit sipas raportit te Drejtorise.
Ne rast te zmadhimit te kapitalit me perfshirjen e rezervave, te fitimeve ose primive te emetimit, asambleja vendos sipas kushteve te quorumit dhe shumices sipas nenit 11 te ketij statuti.



NENI 15

Aksioneret kane te drejte perparesie ne nenshkrim per rritjen e kapitalit me para ne dore, propocionalisht me shumen e aksioneve qe zoterojne. Asambleja qe vendos per zmadhimin e kapitalit mund te heqe te drejten e perparesise se nenshkrimit, vendim qe merret ne baze te raportit te Drejtorit te ekspertit kontabel.

E drejta e nenshkrimit duke ushtruar brenda 20 diteve nga data e celjes se nenshkrimit.

NENI 16

Zvogelimi i kapitalit ose vendoset nga Asambleja e jashtezakonshme. Projekti i zvogelimit te kapitalit i komunikohet ekspertit kontabel te autorizuar 45 dite para mbledhjes se asamblese se aksionereve.

NENI 17

Aksionet e shoqerise do te jene ne formen nominative. Aksioni nomitaiv u transferohet te treteve dhe personit juridik emetues nepermjet nje transferimi ne regjistrat qe shoqeria mban per kete qellim dhe qe permbajne treguesit perkates te operacioneve te transferimit dhe shnderrimit te aksioneve.

NENI 18

Aksionet jane te tregueshme vetem pas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe ne rast zmadhimi te kapitalit pas regjistrimit te ketij zmadhimi.

Me perjashtim te rasteve te trashgimise transferimi I trashgimise, transferimi I pronesise se aksioneve e nenshkrtohet te drejtes se parablertes se aksionereve.

Kur emetohen aksione te reja te shoqerise zbatohet perparesia ne nenshkrimin e aksionereve propocionalisht me aksionet qe zoterojne.

Ne rast se aksioneret terhiqen nga kjo e drejte te tretet fitojne te drejten per t'i blere ato me te njejtat kushte.

Ne rast se ndonjeri nga aksioneret do te shesi aksionet e tij ai eshte i detyruar t'i ofroje ato se pari tek aksioneret e tjere te shoqerise me cmim dhe kushte shitjeje te percaktuar nga ai vete. Numri i aksioneve me cmimin e shitjes i ofrohen se pari aksionereve ekzistues brenda shoqerise me te

drejten e perparësise me nenshkrim propocionalisht me shumen e aksioneve qe aoterojne.

Ne rast se aksioneret terhiqen nga kjo e drejte te tretet fitojne te drejten per t'i bleren ato me te njetat kushte.

Aksioneri shites nuk ka te drejte te shese tek te tretet me kushte favorizuese se ato qe u kas ofruar aksionereve.

Ne rast se aksioneri shites nuk gjen bleres te trete me cmimin e pare te ofruar dhe vendose te shese me cmim te ulet rifillon proceduren e mesiperme.

NENI 19

Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik apo juridik shqiptar apo te huaj.

Keshilli Mbikqyres duhet t'i paraqes nje kerkese ku percaktohet identiteti i plote i personave fizike ose juridike qe jane ofruar si bleresa, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronësise dhe cmimi i ofruar.

Mirati i i Keshillit Mbikqyres konsiderohet i dhene edhe kur ky Keshill nuk jep pergjigje me kalimin e tre muajve nga data e paraqitjes se kerkeses.

KAPITULLI V^{te}

KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 20

Eksperti Kontabel

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar te cilet emerohen nga Asamblea e Zakonshem dhe kryejne funksionin ne pajtim me ligjin.

Eksperti i pare kontabel emerohet z.Namik VEIPI.


Ne çdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose veç e veç bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre dhe ne veçanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve. Ekspertet kontabel informojne Drejtorn e Pergjithshem dhe Keshillin Mbikqyres per:

- *kontrollet , verifikimet dhe sondazhet qe ka kryer*
- *pjeset e bilancit dhe dokumentave te tjere te kontabilitetit ku ata kane verejtje*
- *parregullsite dhe pasaktesite qe kane zhvilluar.*

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllin llograite e vitit financiar si dhe ne mbledhjes e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edshe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin dhe nenvlefestimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe



kane. Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqeris. Keshilli Mbikqyrës me rastin e miratimit te eksperteve miraton edhe masen e shperblimit te tyre.



NENI 21

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat e ardhura nga vperimet e tyre te fajshme.

KAPITULLI VI^{te} ***PRISHJA E SHOQERISE***

NENI 22

Prishja e shoqerise vendoset nga asamblea e jashtezakonshme. Neqoftese si pajoje e humbjeve te konstatuara ne dokumentat kontabel, kapitalet e shoqerise behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, shoqeria detyrohet, brenda 4 muajve nga miratimi i bilancit financiar ku eshte konstatuar humbja te therrase asamblene e jashtezakonshme per te vendosur nese ka vend per prishjen e shoqerise. Ky vendim merret me shumicen e votave qe kerkohen edhe per ndryshimet ne statut. Ne mungese te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme cdo i interesuar mund te kryeje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise.


NENI 23

Ne kete rast ajo vihet ne likujdim. Likujdimi behet ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare". Asamblea e jashtezakonshem cakton likuidatoren duke u percaktuar edhe fuqite qe ata do te kene.

KAPITULLI VII^{te} ***DISPOZITA PERFUNDIMTARE***

NENI 24 **Ushtrimi financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 01 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushkrimi i pare financiar perfshin kohen nga datat e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri me 31 dhjetor



NENI 25
Bilanci vjetor

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesen ligjore. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori sipas struktures dhe permbajtjes se percaktuar ne planin kontabel pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tre mujor dhe ate vjetor. Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, per kontabilitetin si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar ku parashikohen edhe ndryshimet ne te ardhmen si dhe veprimtarite e tjera te shoqerise.

NENI 26
Miratimi i bilancit

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise i detajuar per te gjitha operacionet si dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se zakonshme te aksionereve.


NENI 27
Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat


Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet, provizionet dhe taksat. Nga fitimet e ushtrimit te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme hiqen te pakten 5% per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar. Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar kur eshte rasti per humbjet e meparshme shoqeria do te heqe jo me shume se 85% per krijimin e rezervave per zhvillim. Asambleja e zakonshme new rast nevoje mund te formoje edhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave te krijuara me siper perfaqson dividentin. Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e zakonshme, propocionalisht me pjesemarrjet e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 28
Pergjegjesite ndaj shtetit

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit.





NENI 29

Transferimi ne shoqeri me oferte publike

Shoqeria "*CENO*" Sh.A. pa oferte publike mund te transferohet ne shoqeri me oferte publike. Vendimi per kete transformim merret e Asambleja e jashtezakonshme.

NENI 30

Fshehtesia e informacionit dhe konfidencialiteti

Te gjithë aksioneret , anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori i Pergjithshem dhe te gjithë te punesuarit ne shoqerine *CENO Sh.A.* jane te detyruar te ruajne fshehtesine e çdo informacioni apo te dhene ne lidhje direkte me shoqerine, per te cilen ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre ose ne menyre te terthorte. Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne procedurat e percaktuara per te penguar perhapjen e cfaredolloj forme te informacionit.

Te gjithë aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori dhe te gjithë te punesuarit ne shoqeri, pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaton shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.

NENI 31

Mosmarrevshjet

Per mosmarrevshjet midis aksionereve, te punesuarve dhe personave te trete kontraktues ne rast se zgjidhja e ceshtjes nuk arrihet me mirekuptim, ajo behet objekt i Gjykates kopetente.

NENI 32

Marrdheniet me punonjesit

Per mosmarrevshjet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit te Punes ne Republiken e Shqiperise.

NENI 33

Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri

Shoqeria nuk prishet kur falimenton kur vdes ose shfaq paaftesi njeri prej aksionereve.

NENI 34

Vula dhe stema

Shoqeria ka vulen e vete (e rumbullaket dhe ne te anash perimetrit shkruhet

"CENO" SH.A., ndersa ne mes eshe figura e stemes se shoqerise).
Cdo departament, filial dege ose perfaqsi ka gjithashtu vulen e vet, me
specifikimet perkatese, te ndryshme nga ato te shoqerise.

NENI 35
Gjuha dhe kopjet origjinale

Ky statut eshe hartuar ne gjuhen shqip ne *GJASHTE* kopje dhe me fuqi te
njejte.

Rastet e paparashikuara ne kete statut do te trajtohen duke u bazuar ne
ligjin "Per shoqerite tregtare", Nr. 7638 date 19.11.1992 dhene akte te tjera
ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKU THEMELUES: Vlender Ceno

Vlore, me nentembedhete shkurt dymije e pese